



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 304/1229
Dt. Rregj. 04.05.2015

Nr. Vendimi 53
Dt. Vendimi 25.01.2016

V E N D I M

“ Per nxjerrjen e ceshtjes jasht juridiksionit gjyqësor”

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Shkoder, e perbere nga:

Valbona Durraj – Gjyqtare

Asistuar nga sekretare seance Borana LITI, sot me datë 25.01.2016, ora 11.30, mori në shqyrtim në seancë pergatitore çështjen administrative me nr.Rregj. Them.304/1229 datë 04.05.2015 që I përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS: Nuriye Bushati, person fizik, regjistruar me NIPT K37408022R, me seli ne L."Perash", Bulevardi "Mehmet Pashe Plaku" Shkoder.

TE PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder, me seli ne Godinen e qendres Informatike, Bulevardi "Parruce" Shkoder,përfaqsuar nga znj.Siriana Bakushi.
Drejtoria e Apelimit Tatimor, me seli ne Rrugen "Gjin Bue Shpata" prane stadiumit "Selman Stermasi", Tirane(në mungesë).

Me pjesmarrie te: Avokatura e Shtetit (në mungesë).

OBJEKTI: Kerkohet shfuqizimi I aktit vendimit te apelimit nr.33557/3 prot. date 01.04.2015 I Drejtorise se Apelimit Tatimor, lidhur me faljen/e detyrimit tatimor dhe doganor sipas ligjit nr. 10418 date 21.04.2011 per "Legalizimin e kapitalit dhe faljen e nje pjese te borxhit tatimor e doganor".

BAZA LIGJORE: Nenet 17/a, 7/a, 15/a te ligjit 49/2012" Per organizimin dhe funksionimin e Gjykates Administrative. Neni 31,32 e vijues I K.Pr.Civile, neni 106i ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per Proçedurat Tatimore ne R.Sh".

Gjykata pasi shqyrtoi padine e pales paditese konstaton se nuk është ezauruar rruga administrative,

VEREN SE

Paditësi, personi fizik Nuriye Bushati me nr. NIPTI K37408022R, i është drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Shkoder me kerkese padi kunder palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder dhe Drejtorisë së Apelitit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, me objekt: shfuqizim i aktit vendimit te apelitit nr.33557/3 prot. date 01.04.2015 te Drejtorise se Apelitit Tatimor, lidhur me faljen e detyrimit tatimor dhe doganor sipas ligjit nr. 10418 date 21.04.2011 "Per Legalizimin e kapitalit dhe faljen e nje pjese te borxhit tatimor e doganor".

Rrethanat e ceshtjes;

Pala paditese eshte nje person fizik , me nr. NIPTI K37408022R, me aktivitet farmaci

Me shkresën nr.10146/3 prot datë 06.12.2010 te Drejtorisë Tatimore Shkodër, me objekt "Njoftim vlersimi per detyrimet tatimore", është njoftuar subjekti për detyrimet e tij, si rezultat i mospageses brenda afatit ligjor të;

TAPBV per vitin 2008 ; tatim 66887 detyrim per tu paguar, kamatvonesa 14643 dhe gjobe 16722 dënim për tu paguar .

TAPBV për vitin 2009 , tatim 211229 detyrim për tu paguar kamatvonesa në masën 18159 dhe gjoba 52807 dënim për pagesë të vonuar

Pala paditëse në bazë të të gjithë dokumentacionit te deklarimit te tatimit mbi te ardhurat personale te periudhave objekt vlersimi te cituar ne shkresen nr 10146/3 prot datë 06.12.2010, duke mos qënë dakort me cfarë pretendohet në njoftim vlerësimit e lëshuar nga ana e organit tatimor është drejtuar me kërkesë për heqjen e gjobave për shumën 379.947 lekë nxjerrë nga DRT Shkodër për mos pagesë në afat të detyrimeve tatimore TAP, pranë Drejtorisë së Apelitit Tatimor, kërkesë e cila është protokolluar pranë kësaj pale me datë 26.12.2014

Fillimisht kjo drejtori ka konstatuar mungesë të dokumentacionit (të përcaktuar në udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008 "Për procedurat Tatimore në RSH") dhe i ka kërkuar subjektit që të plotësojë praktikën me kopje të njoftim vlerësimit për detyrimet, objekt apeliti, kopje të proces verbalit të gjobës, si dhe dokumentat bankare që vërtetojnë pagesën e detyrimeve

Pas plotësimit të dokumentacionit nga ana e Subjektit, kjo Drejtori është përgjigjur me vendimin e saj, komunikuar me shkresën nr.33557/3 prot datë 01.04.2015 subjektit dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nëpërmjet të cilit është vendosur:

• Refuzimi i ankimit, **pasi akti administrativ, objekt apeliti , Njoftim vlerësimi për detyrimet nr.10146/13 prot.datë 06.12.2010 është dorëzuar jashtë afateve të përcaktuara në ligjë, nuk janë plotësuar kërkesat ligjore për marrjen në shqyrtim.**

Neni 106 pika 3 i ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, shpreh :

3. Tatimpaguesi e dorëzon ankimin në drejtorinë e Apelitit Tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi"

Gjithashtu në udhëzimin nr. 24 datë 02.08.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar pika 69.4 është përcaktuar se;

69.4 "Personi i tatueshëm që nuk është dakort me njoftim vlerësimin tatimor, ka të drejtë ta ankimojë atë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit në përputhje me procedurat e parashikuara në kreun XIII të ligjit".

(akti administrative objekt apelimi është nxjerrë nga DRT Shkodër me datë 06.12.2010 ndërsa ankimi është depozituar në DPTiranë me datë 26.12.2014)

Po kështu edhe ne reference te nenit 107/4 te ligjit 9920 dt 19.05.2008 ku thuhet:

"Akti administrative i leshuar nga administrata tatimore dhe per te cilin nuk eshte ankimuar ne rruge administrative, nuk mund te ankimohet ne rruge gjyqsore".

Drejtorja e Apelimit Tatimor duke refuzuar kërkesën ankimore të subjektit nuk ka shqyrtuar në thelb çështjen, pra pala paditëse nuk ka ezauruar rrugën administrative të ankimit.

Gjykata në respektim te dispozitave të K.Pr.Civile, neni 36, të cilat janë në harmoni me rregullimet e përcaktuara në ligjin nr.49/2012, neni 9, parashikohet se në juridiksionin gjyqësor hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet që parashikohen në kodet dhe ligjet përkatëse si të tilla.

Sipas nenit 59, paragrafi i pare i K.Pr.Civile, reflektuar edhe në nenin 9 të ligjit nr.49/2012 nisur nga shprehja "gjykata ne çdo faze dhe shkalle gjykimi", i jep te drejte gjykates ta shqyrtoje atë kryesisht.

Në rastin konkret, evidenton se padia objekt shqyrtimi nuk i përket juridiksionit gjyqësor pasi nuk është ezauruar fillimisht rruga administrative e ankimit sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuar në dispozitat e ligjit 9920 dt 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar, per pasoje ne reference te neni 9, 16 te ligjit 49/2012 "Per gjykimet administrative etj....."

Neni 9

Kundërshtimi i juridiksionit

1. Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, kur konstaton se çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, merr vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe dërgimin e akteve organit kompetent..

Neni 16

Kushti për shterimin e ankimit administrativ

1. Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ.

konstaton se paditesja Nuriye Bushati, nuk ka ezauruar rrugen administrative te ankimit ndaj aktit administrative nr.10146/3 prot datë 06.12.2010 te Drejtorisë Tatimore Shkodër, me objekt "Njoftim vlersimi per detyrimet tatimore", per pasoje konform neni 9, te ligjit 49/2012, vendos te nxjerre ceshtjen jashte juridiksionit gjyqësor, prandaj

PER KETO ARSYE

Gjykata konform nenit 9 dhe 16 te ligjit 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

VENDOSI

Nxjerrjen e cështjes jashtë juriksionit gjyqësor për cështjen administrative me nr. rregj.them. 304/1229, datë 04.05.2015 të ngritur nga pala paditëse Nuriye Bushati.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim I vecantë brenda 5 ditëve në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Për palën e paditur Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë dhe për Avokaturën e Shtetit (në mungesë), ky afat fillon nga moment I marrjes dijeni të vendimit.

Shkodër me datë 25.01.2016

SEKRETARE SEANCE
Borana LITI



GJYQTARE
Valbona DURRAJ



VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË

SOT ME DATË 23.02.2016

